



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:197733
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05717083

K.Dh.Sh.II.nr.272/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi Prishtina Sh.A., me seli ne Prishtinë, rr. “Hazir Shala”, nr.4, ndaj debitorit KAN Sh.P.K., me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Ardi Shita avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së Parë, KPPP.nr.1344/22, të datës 22.11.2023, me datë 21.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi Prishtina Sh.A., me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1344/22, të datës 22.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1344/22, të datës 22.11.2023, në dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit KAN Sh.P.K., me seli në Prishtinë dhe e ka anuluar urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.326/21 të datës 25.03.2021, të përmbartuesit privat Arsim I. Bajraktari me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve thelbësore të procedurës përmbarimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim, që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, ashtu që të anulohet aktvendimi KPPP.nr.1344/22, të datës 22.11.2023 dhe çështja të kthehet në rivendosje dhe rishqyrtim.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesën e debitorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditori është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale Ujësjellësi Prishtina Sh.A., me seli ne Prishtinë, me datë 25.03.2021 ka paraqitur propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktin i verifikuar nga librat afarist me shifër K044015, me propozim që të detyrohet debitori që kreditorit t’ia paguaj shumën prej 526.18 euro, si dhe ka kërkuar të gjitha shpenzimet e përmbarimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Përmbaruesi Privat Arsim I. Bajraktari me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin përmbarimor P.nr.326/21 të datës 25.03.2021, e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke theksuar se me Urdhrin Përmbarimor të iniciuar në bazë të dokumentit të besueshme, borxhi i pretenduar nga kreditori është i pa saktë, pasi që asnjë nga faturat nuk janë pranuar që të paguhen ndaj kreditorit, dhe se të gjitha fatura janë paguar nga debitori, ashtu që i ka propozuar gjykatës që të miratohet prapësimi i debitorit si i themelte dhe të refuzohet Urdhri Përmbarimor dhe shpenzimet të procedurës.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar pala kreditore, duke theksuar se kundërshtimi i debitorit është i pabazuar, andaj i ka propozuar gjykatës që të mbetet në fuqi Urdhri i përmbaruesit privat për caktimin e përmbarimit P.nr.326/21 të datës 25.03.2021.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1344/22, të datës 22.11.2023, në dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit KAN Sh.P.K., me seli në Prishtinë dhe e ka anuluar urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.326/21 të datës 25.03.2021, të përmbaruesit privat Arsim I. Bajraktari me seli në Prishtinë.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit lidhur me parashkrimin ka ardhur në përfundim se në këtë çështje prapësimi i debitorit është i bazuar, ku ka vlerësuar se bazuar në nenin 29 i cili nën para. 1.2 dhe 1.3 të LPP-së përcakton se : *” Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është:”... 1.2 “ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”, 1.3 “faturat”, ndërsa para. 3 i këtij neni ka përcaktuar se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.* Në anën tjetër neni 37 të LPP-së thekson se : *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.* Gjykata ka anuluar urdhërin përmbarimor P.nr.326/21 të datës 25.03.2021, për shkak se dokument i besueshëm do të pranohet vetëm ekstrakti nga librat afarist të ndërmarrjes që ofrojnë shërbime komunale lidhur me furnizimin me energji elektrike, furnizim me ujë dhe me bartjen e mbeturinave, ndërsa ekstraktet e ndërmarrjeve lidhur me shërbimet tjera nuk përfshihet në këtë definicion, gjithashtu në këtë rast ky ekstrakt nuk është dokument i besueshëm pasi që nuk përshkruhen saktë se për cilat shërbime kanë qenë objekt i këtij dokumenti dhe gjithashtu rezulton që shumat 526.18 euro është kërkuar për periudhën kohore 01.01.2013 deri me datën 23.03.2021, ndërsa përmbajtja e ekstraktit nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 e deri me datën 31.10.2020, me çrast nuk dihet për cilën periudhë kohorë edhe grumbulluar borxhi në fjalë, prandaj nuk paraqitet dokument i besueshëm.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përbarimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në bazë të nenin 29 i cili nën para. 1.2 dhe 1.3 të LPP-së përcakton se ” *Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është:*” ndërsa sipas nën paragrafi 1.2 “*ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, dhe nën paragrafi 1.3 “*faturat*”, ndërsa paragrafi 3 i këtij neni ka përcaktuar se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Nga shkresat e lëndës konstatohet se Ekstraktin i verifikuar nga librat afarist me shifër K044015, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe nuk i përmbanë të gjitha elementet e kërkuar nga nenin 29 të LPP-së. Në anën tjetër neni 37 të LPP-së “*Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”, prandaj urdhëri përbarimor duhet të refuzohet dhe nuk ka mbështetje ligjore.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës kreditore, lidhur se ekstrakti dhe fatura i plotësojnë kushtet nga nenin 29 të LPP-së, për të qen dokument i përbarueshëm, mirëpo të njëjtin gjykata e refuzon si të pabazuar dhe të pa mbështetura sepse këto dokumente të propozuar në propozim për përbarim nuk plotësoj kushte

nga neni 29 dhe 37 të LPP-së për të qenë të përmbareshëm dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbareshëm.

Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e ankimuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë
K.Dh.Sh.II.nr.272/24, me datë 21.05.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri